



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITES
Nr.01-060/01-7774/23 datë:22.03.2023



Npi – 01/109 datë: 30.03.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 30.03.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë -III- T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S
E mbajtur më: 30.03.2023, (e enjte) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrush, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtorët, z.Muhamet Hoxha RZSH, z.Agim Ademi gazetar nga Koha, Nga OSBE, z.Kimete Jashanica, znj.Anita Kurti, Shefe e Kabinetit të Kryetarit, Praktikantja, znj.Valmira Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.02.2023, dhe 14.03.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes,
4. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
5. Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë të Prokurimit.
6. **Rishqyrtimi i nenit 11 të Rregullores Komunale për Taksa për vitin 2023 sipas U.A. të MASHT-it, (Pikë Shtesë)**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fillimisht urojë agjerimin e lehtë për muajin e Ramazanit për të gjithë besimtarët musliman, para se ta hapim diskutimin për rendin e ditës unë propozoj që ta fusim një pikë shtesë, që ka ardhur nga Ministria për rishqyrtim, “Rishqyrtimi i nenit 11 të Rregullores Komunale për Taksa për vitin 2023 sipas U.A. të MASHT-it”.

z.Adem Ramadani; Përshëndetje, unë në fillim po u bëjë një thirrje, që me 2 Prill me marrë pjesë në Marsh për të gjithë të interesuarit. Sa i përket rendit të ditës ne jemi “pro”.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, fillimisht dua të bëjë një apel për të gjithë pjestarët që me 2 Prill të marrshojmë për ata që padrejtësisht, sot mbahen në Hagë. Jemi për rendin e ditës edhe për pikën shtesë të MASHT-it, por nuk i përkrahim praktikën që 5 minuta para mbledhjes të na dërgoni materialin shtesë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi rendin e ditës me pikën e 6 shtesë “Rishqyrtimi i nenit 11 të Rregullores Komunale për Taksa për vitin 2023 sipas U.A. të MASHT-it”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.02.2023, dhe 14.03.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Albana Podvorica; Përshëndetje, pyetjen që e kamë bërë unë kërkoj që të më kthehet përgjigje nga drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

z.Isa Haxhiu, DSHMS; Në pikën e dytë do ta japë përgjigjen.

***Kuvendi i Komunes, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më datat: 28.02.2023 dhe më 14.03.2023.**

Pika 2

Pyetje – përgjigje

Përgjigje: z.Isa Haxhiu, DSHMS; Përshëndetje, sa i perket pyetjes së znj.Albana Podvorica si dhe pyetjeve të tjera unë jamë përgjigjur me shkrim. Unë kamë mabjtur evidencë sepse mua nuk më kanë ardhur të gjitha pyetjet. Prandaj unë do ti lexoj përgjigjet në të gjitha pyetjet, në vazdhim lexoi përgjigjet (shih dokumentin).

znj.Albana Podvorica; Pyetje për DKA-në, mësimdhënësit po kanë problem me printerat, a ka ndonjë zgjidhje për këtë? Pyetje për DSHP-në, rruga “Mihail Grameno” në kohën e dimrit është e pa kalueshme, çka do të ndërmerrni për këtë rrugë? Pyetje për Kryetarin, çerdhet që i keni premtuar kur do ti realizoni?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Pyetje për DKA-në, a e keni pranuar një ankesë nga Gentrin Musliu dhe a është shqyrtuar ankesa e tij?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DPUKGJ-në, sa është numri i objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore?

znj.Adelina Beqaj; Pyetje për DPUKGJ-në, në fshatin Belinc trotuari është dëmtuar, pse nuk po ndërmerrni diçka? Pyetje për DSHP-në, kanalizimi në rrugën e Ferizait ka dalë mbi tokë kur do të rregullohet?

z.Besnik Seferi; Te konkurset është bërë mediatike, duke përfshirë familjarë çka ka ndodhur me këtë konkurs? Pyetja e dytë për DPUKGJ-në, në fshatin Gjyrcovc ka nevojë për ndriçim çka do të bëhet? Pyetja e tretë për DPUKGJ-në, në fshatin Gjyrcovc edhe Trafoja e rrymës është shqetësim, sepse janë ankuar se po na i prishë pajisjet, çka do të bëhet me të? Pyetje për DSHMS-në, te QKMF-ja ka qenë një punëtorë i komunitetit pakicë, të cilin e ka zëvendësuar një punëtor i komunitetit shumicë pse?

z.Hamëz Tërshani; Pyetje për DSHMS-në, rëntgeni nuk po punon që një javë në QKMF-ë a je drejtor në dijeni, dhe pse nuk po bini kuadro nga jashtë kur ju jeni të njohur për këtë? Pyetje për Kryetarin, çka ka ndodhur me unazën e qytetit ku ka mbërri kjo? Pyetje për DSHP-në, Pjesa e rrugës Tranzit është e tmerrshme, na keni akuzua neve por çka jeni tu be ju?

z.Reshat Mujota; Pyetja e parë për DKA-në, për pagesën e Shujtave dhe Udhëtimeve për 150 arsimtar e që bëjnë mbi 200.000€ këto duhet me i paguar çka po ndodhë me to kjo ka qenë pyetja ime? Pyetje për DKRS-në, drejtoresha në përgjigje mu ka drejtuar me “ti” e që nuk është etike?

z.Rexhep Gashi; Pyetje për DPUKGJ-në, sa leje ndërtimore i ka lëshuar drejtoria? Pyetje për DSHP-në, pse nuk po funksionojnë kamerat publike? Pyetje për Kryetarin, Kur do ta zgjidhni problemin e banimit te Fitorja, ku dihet që aty i kemi 9 banesa, çka keni bërë?

Përgjigje: Kryetari, z.Qemajl Aliu - Faleminderit për pyetjen, ne jemi duke i bërë një analizë procesit të dhënies me koncesion të këtij objekti pasi ka dyshime që aty është manipuluar dhe në fund të këtij procesi do të kemi një përgjigje të saktë se sa vërtet Komuna e Shtimes ka pronësi në atë objekt dhe nëse ky proces ka qenë i rregullt dhe konform ligjit.

z.Përparim Ramusa; Pyetje për DSHMS-në, si është e mundur kur thatë se nuk ka të interesuar në konkurs për drejtor kur ju nuk keni hapur konkurs, e QKMF-ja që 16 muaj punon me Ushtrues Detyre? Pyetje për Kryetarin, Përkundër premtimit për shkollë të re, tash na i ke sjellë këtu për bartjen e mjeteve për renovim?

Përgjigje: Kryetari, z.Qemajl Aliu - Faleminderit për pyetjen, lidhur me shkollën e Petrovës - ne do ta braktisim idenë e abuzimit me objektet e mëdha, të cilat janë të panevojshme. Ne mendojmë që shkolla e fshatit Petrovë, me numrin e nxënësve që ka nuk ka nevojë për objekt të ri. Aneksin e vjetër do ta rrëzojmë dhe do ta ndërtojmë një aneks të ri në atë vend, me ç'rast do ta bëjmë një renovim gjeneral të gjithë objektit për të pasur një objekt bashkëkohor dhe funksional për të gjithë nxënësit që vijnë shkollën "Bajram Curri". Kjo do të realizohet besoj në vitin e ardhshëm, pretendojmë të fusim në buxhetin e vitit 2024 në kuadër të Ministrisë së Arsimit.

znj.Zejnije Veliu; Pyetje për DPUKGJ-në, kërkesa e banorëve të fshatit Pjetërshicë për ndriçim publik, deri ku ka arritur realizimi i kësaj kërkesë?

z.Rrahman Jakupi; Po e përsëris pyetjen e 4 për DSHMS-në, lidhur me mungesën e mjekëve dhe infermierëve në QKMF, a jeni duke pritur me diplomuar anëtarët e tuaj politik dhe me i punësuar ata, pse nuk po hapen konkurset? Pyetje për DSHMS-në, sa kohë ju duhet me shpallë konkursin për drejtor në QKMF-ë? Pyetje për DSHMS-në, kur do të ndërtohet objekti i QKMF-së, sepse po dëmtohen bizneset aty?

Përgjigje: z.Isa Haxhiu, DSHMS; Sa i përket pyetjes së Besnikut, unë nuk e di që ka pas konkurs të hapur për këtë vend pune, vetëm nëse është bërë me "Karitas". Kur kemi ardhur ne e kemi gjetur QKMF-në pa drejtor, me arsyetimin se ish drejtori ka thënë se me këtë strukturë nuk dua të punojë. Sa i përket zgjedhjes së drejtorit nga kuadri i brendshëm i QKMF-së na kanë thënë se nuk i plotëson kriteret asnjë nga të punësuarit aty, e nuk qëndron deklarimi i zotëri, Jakupit "se po pritini që të diplomojë dikush nga partia". Lidhur me peticionin për lokacionin e QKMF-së, zotri, Jakupi në një televizion ju keni thënë vetë se i takon Komunës që të caktojë lokacionin e QKMF-së. Në QPS-ë, po ashtu ka pas, Ushtrues Detyre të cilin e ka zgjedhur struktura e kaluar, e i cili ka shkuar në Ferizaj. QPS-ja nga fillimi ka pas mungesë të kuadrit, janë pensionuar dy dhe i kemi pranuar dy. Në vazhdim z.Isa Haxhiu, lexoi përgjigjen e tijë dhënë palës z.Sylejman Bajramit.

QKMF-ja do të ndërtohet në lokacionin në mes të Stacionit të Policisë dhe Shkollës Profesionale.

z.Përparim Ramusa; Unë nuk mora përgjigje, pse që 16 muaj nuk keni hapur konkurs?

z.Isa Haxhiu, DSHMS; Thash se QKMF-në e kemi gjetur pa drejtor, dhe po ashtu thash se nuk kemi kuadër që i plotëson kriteret për konkurs të brendshëm në QKMF-ë.

Përgjigje: z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Disa prej pyetjeve kanë nevojë për analizë më të detajuar dhe nevojitet kohë për tu përgjigjur. E di problemin të rruga "Mihail Grameno" por punë-kryesi është i obliguar me e kthyer në gjendjen e mëparshme. Sa i përket pyetjes së znj.Adelina Beqaj, uji që po del mbi sipërfaqe të rruga "Komandant Kumanova" nuk ka të bëjë asgjë me ujërat e zeza të kanalizimit, por ai ujë është atmosferik i cili po rrjedh nga kodra afër. Pyetja e z.Hamzë Tërshanit, Kontrata nuk ka pas edhe ndërtimin e zebrave, dhe ti më së paku mundesh me u mburrë me këtë. Zebrat do të kryhen tash së shpejti me kontratën e re.

Përgjigje: znj.Yllkë Fejzullahu; Pyetjet që u parashtruan faktikisht kanë qenë edhe nga mbledhja e kaluar. E kemi Kompaninë e cila do të merret me renovimin. Te pyetja e znj.Besartë Musliu, deri sot unë nuk kamë pa që zotëri Muslija kë bërë ankesë, por sigurisht që nëse e ka bërë ankesën ajo do të shqyrtohet. Për sa i përket konkurseve, secili që paraqitet me ankesë në do ti përgjigjem. Te pyetja e z.Besnikut, në mungesë të njerëzve të kualifikuar në konkurs ne jemi të detyruar për me bërë zgjidhjen e mundshme.

z.Reshat Mujota; Per me terhjek fjalën eshte çeshtje personale dhe dua ta mbylli me kaq.

Përgjigje: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përhëndetje për të gjithë, u bënë disa pyetje, znj.Albana Podvorica, për Çerdhen kur do të bëhet, jemi në fazën e projektimit për renovim, janë dhënë 100.000€, dhe secilën do ta qojmë në renovim sepse ka nevojë edhe për këto Çerdhe, ndërkaq që në fshatin Muzeqinë veç kanë filluar punimet. Kemi fat të mirë që nga Ministria janë ndarë mjete edhe për Çerdhen në Godanc, dhe sa më parë do të fillojnë punimet. Në Petrovë siç e dini kemi pas problem me caktimin e lokacionit që nuk e

kanë votuar opozita. Vitin e ardhshëm do të insistojmë që edhe Çerdhja në Petrovë të buxhetohet. Po e shikojmë mundësinë e adoptimit të Çerdheve në Carralevë dhe në Pjetërshticë. Në rrugën “17 Shkurti” kanë filluar punimet por operatori nuk ka punuar sipas kriterëve, dhe menaxheri i kontratës ka shumë vërejtje, për këtë arsye jemi në fazën për shkëputjen e kontratës me operatorin. Te rruga “14 Dhjetori” kontrata është nënshkruar, dhe puna pritet të fillojë me 3 ose 4 Prill 2023. Me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” e kemi arritur një Memorandum Mirëkuptimi, për ndërtimin e 30 shtëpive, nevojitet një komision për përzgjedhjen e listës. Për 10 shtëpitë e para së shpejti do të fillojnë punët. Premtimet që i kemi bërë janë 107, brenda mandatit dmth. deri në përfundim të mandatit ne do ti përmbushim mbi 107 e ndoshta edhe 170. Shpronësimet sigurisht që do ti bëjmë, mirëpo paraprakisht edhe komisioni për vlerësimin e pronave i Ministrisë fillimisht duhet ta bëjë punën e tij. Sa i përket vlerës së shpronësimit ne nuk do ti mbetemi borgj askujt. Për sa i përket ndërtimit të QKMF-së e sqaroj dr.Isa Haxhiu. Për sa i përket nepotizmit, dhe asaj që u tha “a po pritni me diplomuar anëtarët e juaj”, këto janë paragjykimet e juaja, e të cilat në realitet i keni bërë ju sa ishit në pushtet, dhe këto janë praktika të juaja për të cilat e keni paguar faturën. Në Çerdhen “Albiona Asllani” është pranuar znj.Selvete Asllani, nga familja martire Asllani e fshatit Rancë për të cilën mendoj se është bërë shumë mirë. Po ashtu në punë është pranuar edhe znj.Lumnije Sopa nga fshati Gjyrkovc, e cila është motër e Dëshmorit. Rasti tjetër e pranuar është znj.Hazbije Muharremi, që është një nënë e jetimave, për të cilën po ashtu mendoj se është bërë mirë që është pranuar. Këta tre emra të punësuarve që i përmenda mjaftojnë për të treguar se këtu nuk ka vend për nepotizëm.

z.Përparim Ramusa; Drejtoresha e arsimit nuk është mirë me mbajte ders këtu, por vetëm të përgjigjet pyetjeve. Kryetar e thae një të pa vërtetë të kulluar se opozita nuk e ka votuar lokacionin e Çerdhes në Petrovë. Në Qershor është votuar Lokacioni, e në Dhjetor është votuar Buxheti. Hazbija ka qenë në pauzë sepse e ke qitë ti prej pune.

z.Reshat Mujota; Në muajin e Ramazanit duhet me bërë pak rahmet sepse punët munden me shkua pastaj keq. Drejtoresha e arsimit është përgjigjur për dikën tjetër kur e ka marrë mandatin. 13 raste tjera janë nepotizëm që sillen këtu brenda te drejtorët te kryesuesi etj. ndashi ua përmendi me emra. Kërkoj nga drejtoresha e arsimit që ta tërheq fjalën “Aludim” për sa i përket ish-drejtorit të arsimit sepse këtë unë e kuptoj si shpifje.

z.Rexhep Gashi; E kemi një rregullore. Pyetje për Kryetarin i cili e devijoi, unë pyeta për banesat te “Fitorja” çka ka ndodhur me banesat që po rrinë.

z.Kadri Emini; Te aludimi i Besnikut për pranimin e punëtorëve, e në fund edhe të Reshatit. Unë jam jurist me profesion dhe Udhëzimi Administrativ nuk e përcakton, se cili është profesioni më i përafërt.

z.Besnik Seferi; Nuk du me u kapë por erdhi situata deri këtu. Mirë u bë që u kuptua tani se bashkëshorten time nuk e ka shti në punë PDK-ja, sepse shumë është aluduar ashtu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Foli për nepotizmin dhe punësimet, gati të gjithë janë të përfshirë, në një formë ose një tjetër, sepse ne jemi vend i vogël dhe njihemi të gjithë, por më e rëndësishmja është që le të punësohet ai/a jo që është më i merituari, dhe që i plotëson kushtet ligjore, pa marrë parasysh se në cilin subjekt politik është.

Pika 3

Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fillimisht lexoi Rekomandimin nga KPF-ë dhe sqaroj Propozim-Vendimin për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane, qelësi për formimin e Komisionit është ashtu që përbërja është gjithsejt anëtarë janë 7, nga ky numër 4 anëtarë duhet të jenë nga Kuvendi, pastaj 3 anëtarë nga Ekzekutivi, 1 nga OJQ-të dhe 1 nga përfaqësuesit e fshatit.

z.Përparim Ramusa; Ashtu sikurse edhe në KPF-ë nuk mundë të japim tash emrat sepse kemi kërkuar edhe emrat nga Ekzekutivi dhe nga OJQ-të. Kërkojmë procesverbalin nga OJQ-të për emrin e tyre.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Përsëendetje, unë e propozojë vetin nga Ekzekutivi dhe nga OJQ-të znj.Zhaneta Demiri.

z.Përparim Ramusa; Ne në KPF-ë kemi thënë jo nga stafi politik. Prandaj kështu ne jemi kundër, për këto dy arsye.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Drejtori Valon Januzi ka qenë edhe në Komision për hartimin e rregullores dhe më së miri e njeh çështjen.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Neni 4 i rregullores e thotë qarte se një përfaqësues është nga Ekzekutivi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne këtë çështjen për stafin politik e kemi vlerësuar gabimisht në KPF-ë.

z.Reshat Mujota; Për mua nuk prish punë edhe pse është politik, asambleja e vendos unë e propozojë veten Reshat Mujota dhe Rexhep Gashin. Kështu ju po doni dhe ja bëjmë pra kështu.

z.Përparim Ramusa; Ne emër të grupit parlamentar kërkojë që të shtyhet për mbledhjen e radhës. Unë do të votoj për me u shty kjo pikë për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ashtu kështu ne jemi vonë, ne tash duhet të përgaditemi për regjistrimin e popullsisë, dhe prap të shtyhet. Duhet pas parasysh faktin se zgjedhjen do ta bëjnë banorë e jo ne.

z.Besnik Seferi; Ne bashkërisht e kemi bërë rregulloren, kështu që nëse e shtyejmë veq kemi me e koklavitur edhe më shumë e jo me bërë zgjidhje. Edhe rregullorja e thotë kështu dhe skemi çka e vazhdojmë më shumë. Sa i përket kuotës gjinore në Komision duhet ti kemi dy femra.

z.Muhamet Ademaj; Unë e propozoj znj.Rrezartë Ramadani nga koalicioni LDK-AKR.

z.Përparim Ramusa; Propozojë 10 minuta pauzë për me shqyrtua këtë çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; 10 minuta pauzë në ora: 12:23h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mbledhjen e vazhdoi në ora: 12:33h. Në emër të grupit parlamentar fjalën e ke ti z.Ramusa.

z.Përparim Ramusa; Te ky Komision nuk jeni të singert, prandaj po kërkoj që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe po kërkoj qwë ta hedhni në votim. Ju po i merrni 4 dhe neve si opozitë po na i leni vetem 1.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne në KPF-ë kemi vendosur politikisht gabimisht, sepse neni 4 i rregullores e thote qartë numrin e anëtarëve nga ekzekutivi, dhe tjetra nëse e shtyejmë nuk bëjmë asnjë zgjidhje.

z.Reshat Mujota; Këta nuk mund ti merrin 4 sepse vota e përcakton. Unë jam për me gjete zgjidhje, kështu që unë po tërhiqem për me bë zgjidhje. Propozoj që ta gjejmë një balancë. Që ti votoni kta nuk më pengon, por te OJQ-të jo na me ja caktuar.

z.Kadri Emini; U kriju një situatë e pa lakmueshme, unë e tërheku propozimin tonë të LDK-AKR. Nga OJQ-të për ne është në rregull, sepse asnjëherë nuk është kërkuar procesverbal nga OJQ-të deri tash.

z.Besnik Seferi; Unë propozoj, përfaqesuese që të jetë znj.Rrezartë Ramadani.

z.Përparim Ramusa; Ne po propozojmë që me u shty kjo pikë, sepse u kriju paqartësi. Ç'ka nëse shoqëria civile ankohen?

z.Adem Ramadani; Asnjë anëtarë i PDK-së nuk është kundër, vetëm po kërkoj me u evidentuar në procesverbal.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Kjo është punë për me u kry sepse kontribuen në interesin e përgjithshëm, nuk jemi duke bërë mirë sepse zvarritja shkon në faturën e qytetarëve dhe 2 pikë nga granti i performacës e cila përkthehet në të mirën e qytetarëve. Shumë po më pyesin pse nuk po themelohen, Këshillat e Fshatrave, ja pra tash është koha, pse nuk po e votoni. Këshillave të kaluara u ka kaluar mandati.

z.Besnik Seferi; U stërzgjat shumë por në të kaluarën vendimet për formimin e komisioneve në të kaluarën, janë marrë edhe pa emër fare të përfaqësuesve nga shoqëria civile, e tash me kërkuar procesverbale, është e pa drejtë. Nuk e di pse po hezitoni. Rregulloren e kemi hartuar dhe miratuar vetë, dhe nuk bënë me e shty më shumë.

z.Lumni Amrushi; Te praktika e mëparshme e Komunës e kemi pas një bashkëpunim.

z.Përparim Ramusa; Pse e votojshe ti pa emër vendimin? Mos i jepni shumë pompozitet rexhistrimit të popullsisë. Për sa i përket grantit të performancës pajtohem me Kryetarin.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ju kisha lutë që ta miratoni, sepse nuk ka nevojë me u shty. E keni kërkuar ja ku e keni. Edhe pozita u tregua zemërgjerë dhe u tërhjek.

z.Reshat Mujota; Unë jam qaj që them se në të mirën e qytetarit duhet me dhanë votën. Ka qenë në të kaluarën që kemi bashkëpunuar me organizatën ndërkombëtare DEMOS. I kemi bërë bashkë fshatrat që kanë me pas vetëm një Kryetarë të fshatit. Unë jam për me e shty veq për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Kam qenë pjesë e rregullores pikërisht te kjo pikë kemi humbë shumë kohë. U.A. na ka përcaktuar në 12 zona.

z.Përparim Ramusa; Thatë me taktikën e juaj, me 3 propozime e mandej kishe po ua falim.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Këtë rregullore e kemi kaluar me 28 Nëntor. Kriteret për caktimet e zonave janë paraparë me U.A. siç janë, numri i banorëve dhe lidhja gjeografike. Te Reçaku e kemi konsideruar si fshat të veçantë për shkak të historikut të fshatit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për”, me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi që pika e 3 (tretë) të rendit të ditës “Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes” të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës.**

Pika 4

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, materialin e keni marrë është i shkurtë dhe preciz. (edhe në vazhdim sqaroj sipas tabelave bartjen e mjeteve), (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DHMS; Përshpëndetje, te numri rendor 12, ZKF-ja kanë kërkuar 20 mijë euro që të kalojnë te kapitalet, për me e ndrruar kodin sepse kanë nevojë për një automjet.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, në vazhdim sqaroj për mjetet e kërkuara dhe tha se pres mbështetjen e juaj.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Përshëndetje, në vazhdim sqaroj se kërkohen mjete për sistemin e digjitalizimit, konsiderojmë se është projekt i mirë, sepse i lehtëson punën e zyrtarëve. Për nevojat e veturave kemi kërkuar rritje sepse edhe çmimet janë ngritur. Veturat që i kemi në dispozicion janë amortizuar, dhe kërkojë që ta përkrahni kërkesën tonë për këto mjete.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, në vazhdim dha sqarime për nevojën për ndarjen e mjeteve. Unë ju ftoj që ta përkrahni dhe ta miratoni këtë pikë.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Përshëndetje, për nevojat e mëdha që i kanë shkollat unë nuk besoj që dikush është kundër, sepse edhe ju vet po kërkonit përmirësimin e kushteve nëpër shkolla. Në vazhdim i përmendi rastet ku ka nevojë të intervenohet me shumat e caktuara, kërkoj miratimin nga ana e juaj sepse janë të nevojshme dhe domosdoshme.

znj.Adelina Beqa; Te shëndetësia e falenderojë drejtorin për planifikimin e blerjes së veturës në QPS-ë. Te Administrata, më mirë me ble barna se sa mjete shtesë për veturë. Po doni me ble paisje, për me na e ndalë fjalën neve në Kuvend. Te DKA-ja, Petrova nuk ka nevojë për renovim por për shkollë të re.

znj.Albana Podvorica; Te DKA-ja, te renovimi i objekteve të shkollave amë unë mendoj se ka nevojë për renovimin e paraleleve të ndara si në Davidovc dhe në Mollopolc.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin e drejtorëve. Pajtohem me ndarjen e propozuar ne do ta votojmë edhe propozimin e doktor Isës, për bartjen e mjeteve.

z.Asllan Beqa; Përshëndetje, unë i ftoj kolegët delegat që ti votojnë mjetet sepse edhe renovimet janë të rëndësishme por edhe ndërtimi i shkollave të reja po ashtu. Ky është problem i kahershëm 20 vjeçarë të qeverisjes së kaluar. Kanë me u ndërtuar edhe Çerdhja edhe Shkolla edhe rrethoja të gjitha. Por jo nga ju, që nuk është bërë asgjë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është mirë me renovu sepse edhe me ndërtu të re para 4 viteve nuk mundemi me hy në te.

z.Rexhep Gashi; E falënderoj ZKF-në për raportin. Të hyrat vetanake, a mund të shkojnë te mallrat dhe shërbime, kur e dimë se ato mirren vetëm te kapitale, nëse mundet atëherë në bazë të cilit ligj.

z.Reshat Mujota; Rexha e sqaroj pak, edhe po e shoh tash. Unë nuk po e shoh të arsyeshme me ble vetura. Te investimet kapitale, jamë sikurse është rruga “Asllani” në Rancë se e meriton. Për shkollat duhet me luftu, kur të bëhet buxheti e jo sot.

z.Besnik Seferi; Unë jamë pro Kryetarit, por i mbajë parimet. Te teknologjia dua të di pak më shumë.

z.Lumni amrushi; Edhe unë kërkoj një shkollë të re në Pjetërshiticë, Adnanistrata po mendon me ble veturë me zero zero. Të pritet pak për Arkivën e të bëhet projekti, premtimi prej 100.000 euro për sport mbaje premtimin e ne i kemi pas 33.000 euro.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit ZKF-ë dhe drejtorave për sçarimet. Parafolësi tha pushteti paraprak nuk ka bërë asgjë, nuk është e vërtetë, qysh mundet njeri me thënë diqka të tillë. Kjo bartje nuk është dedikuar në vendin e caktuar. Në Shtator i keni kërkuar 70 mijë euro, dhe 10 mijë për garazhë gjithësejt 80 mijë euro, tash po i kërkonit edhe 10 mijë që bëjnë 90 mijë euro për vetura. Asnjë cent nuk e ka nda për zonën ekonomike, asnjë cent për mirëmbajtjen e ambientit, për kulturë hajgare 5 mijë euro. Nuk jam kundër bartjes së mjeteve por jam kundër kësaj mënyre të bartjes.

z.Asllan Beqa; Edhe po e shoh edhe po e ndjej shumë mirë, dhe unë nuk kam nevojë fare me dalë në teren, por vetëm nëse i sheh kërkesat e juaja në Kuvend, menjihërë bindesh se qfarë është gjendja në arsim.

z.Përparim Ramusa; Ne i kemi ndërtuar 13 shkolla e ju fotokopjet nuk po mundeni me i ble.

z.Hamëz Tershani; PDK-ja është e njoftur për reformën në arsim. Përparimi i përmendi 13 shkolla e ju ende po mburreni me ndertimet tona. DSHP-ja nuk ka kërkuar asnjë cent për me rritë kulturën e mirëmbajtjes së ambientit.

znj.Zejnie Veliu; Ne jemi dëshmitare të ndërtimit të shkollave pa kritere, dhe pyetja është pse tash duhet të intervenohet në renovimin e shkollave ende pa kaluar as 10 vite. Kjo tregon se farë shkolla janë ndërtuar.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Për ndërtimin e shkollave të Petrovës dhe shkollave të tjera nevojitet fond i madh dhe për buxhetin tonë është i pa përballueshëm ndërtimi i shkollës. Kështu që ne kemi kërkuar nga Ministria mirëpo ajo paraprakisht e bënë studimin e fizibilitetit e pastaj projektimin dhe ndërtimin e sajë. E dini rastin e shkollës në Muzeqinë, për kualitetin e punës. Për Petrovë kemi biseduar me ministrinë që aty të shkolla e vjetër me u rindërtuar dhe me u renovua shkolla e tanishme. Kjo është shpërndarja më e novojshme dhe më e duhura, prandaj ju ftoj që ta përkrahni dhe ta votoni. Kemi një kontratë të trashëguar me një operator të pa përgjegjshëm e lidhur me Prokurorinë Qendrore, dhe ne po mendohemi qka me bërë vetë për me bërë zgjidhje. Për barna këtë vitë i kemi ndarë 127 mijë euro, më parë ishte 40 mijë euro. E kemi gjetë DKRS-në me 33 mijë euro, ndërsa tash i kemi bërë mbi 50 mijë euro. Te DSHP-ja janë mbi 280 mijë euro, se u tha pse nuk ka mjete te DSHP-ja. Tani jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës për mirëmbajtje.

z.Bujar Ferati, ZKF; Do të jap shpjegime shtesë, pse duhet të votohet. Në vazhdim lexoi nenin 9 të Ligjit për bartjen Buxhetore, këto janë arsyetuar nga Kryetari dhe në mbledhjen e drejtorëve, unë ju ftoj që ta votoni pa e shty këtë pikë.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Investimet në Gllavicë me 40 mijë euro. Ministria e Financave e ka ndarë një buxhet prej 10 milion euro. kjo ishte arsya pse nuk kemi kërkuar mjete.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Digjitalizimi është një projekt, tani më i domosdoshëm, edhe në shkolla edhe në Administratë. Te veturat nëse mundeni me e gjetë veturë të mirë me më pak se 25 mijë euro. Duhet pas parasysh se deri tash janë hargjuar 23 mijë euro për qiranë e veturave, kështu që me këtë qmim sa paguajmë qira kjo veturë i mbetet Komunës në pronësi. Pagesa e tillë e qirasë është shumë.

z.Bujar Ferati, ZKF; Qysh është këtu e shkrueme ashtu edhe është paraqitë.

znj.Adelina Beqa; Unë nuk vijë këtu e pa përgaditur por ti Kryesues po vjen i pa përgaditur e dyta ki kujdes se qysh po fol sepse unë jamë grua.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Gati të gjitha u thanë nga Kryetari edhe sa i përket shkollës së Petrovës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Bartjen e mjeteve financiare mund ta bëjmë vetëm te projektet e buxhetuara, nuk mund të bartën për projekte të reja, këtë duhet ta keni parasysh.

z.Reshat Mujota; Unë nuk thash se kjo është bartje, por thash se po krijohen dyshime. Faleminderit Besnik që po me rrin gati.

z.Përparim Ramusa; I kisha lutë ekzekutivin që të jeni të kujdesshëm kur përmendeni gra. Mënyra se qysh i keni caktuar mjetet, ne jemi kundër, nuk ka pas rritje të punimeve nga shtatori, ju jeni një ekzekutiv i papërgaditur dhe i paditur. Sot ne jemi kundër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Me i thëne ekzekutivit jeni të paditur është një fyerje që u bëhet. Nuk mundet me qenë ky propozim-vendim krejt komplet gabim, sepse në të kanë punuar zyrtarë profesionist nga ekzekutivi që janë njerëz me përvojë e ti menjëherë të gjithë të padishëm.

z.Përparim Ramusa; Ne si opozite kemi të drejtë me ju quaj të paditur sepse edhe ju na keni quajtur neve kur ishim në pushtet të paditur. Unë nuk i përmenda të gjitha projektet, mirëpo ne do të jemi kundër.

z.Bujar Ferati, ZKF; Është mirë me u votua sepse nga 80 mijë euro të planifikuara besoj se vjen oferta për vetura me 60 mijë euro nëse jo atëherë i thoni drejtorit të Administratës se ka gabuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për", me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi Propozim-Vendimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual 2023, dhe rritja e kufirit të hyrave.**

Pika 5

Informatë për Planin e Punës të Drejtorisë së Prokurimit

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Ne kërkojmë dhe e propozojmë që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje të ardhëshme të Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 18 vota "Për", me 1 votë "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi që ta shtyejë këtë pikë për mbledhjen e radhës.**

Pika 6 (Pikë Shtesë)

Rishqyrtimi i nenit 11 të Rregullores Komunale për Taksa për vitin 2023 sipas U.A. të MASHT-it,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Nuk mundë të dalim kundër U.A. propozojë që ta hedhni në votim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 18 anetareve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, Npi-01/78 të datës 15.03.2023, si vijon:**

1. Te Neni 11, i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, Npi – 01/78, të datës 15.03.2023, bëhen këto ndryshime si vijon:


Neni 11.1 Duke u bazuar në U.A. të MASHT-it Nr.01/2017 të datës 21.02.2017 për Planifikimin dhe Shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur, pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur është:

11.1.1 Për regjistrimin e vitit.....	100.00 €
11.1.2 Për praktikë profesionale	50.00 €
11.1.3 Provimi diferencial.....	10.00 €
11.1.4 Provimi përfundimtar certifikatën/diploma.....	50.00 €

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e perfundoi në ora: 14:50h.

Procesmbajtësi:

Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi

